

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Rasim Rasimi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit K.S., nga komuna e P., për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit K.S., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr.759/2016 datë 28.02.2017, aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.169/2017 datë 11.05.2017, në seancën e kolegjit e mbajtur më 20 shkurt 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit K.S., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr.759/2016 datë 28.02.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.169/2017 datë 11.05.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.759/2016 datë 28.02.2017, i dënuari K.S. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, dhe është gjykuar me dënim me gjobë në lartësi prej 1500 (njëmijepesëqind) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet në

afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe koha e kaluar në paraburgim nga data 26.09.2016 deri më 28.02.2017, i llogaritet në dënimin me burgim. Nëse i dënuari nuk e paguan gjobën gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me burgim, duke llogaritur një ditë burgim në 20 euro gjobë. I ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, konfiskimin e sasisë prej 62 paketimeve me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 18 kg e 984.8 gr, veturën Golf ngjyrë e kuqe 01-112-EB, telefon IPHONE 013036004816277, kartelë telefoni Z-mobile ..... Është obliguar i dënuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumë aq sa do të llogaritet sipas shpenzimeve përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej 50 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.169/2017 të datës 11.05.2017, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit ashtu që aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të dënuarit i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 29.09.2016 e deri me 28.02.2017, dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind euro) euro.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur , mbrojtësi i të dënuarit K.S. , A.Gj., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 të KPPK dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPPK, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.129/2017 të datës 01.08.2017 ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuar me dispozitën e nenit 384 par.1 pika 1.12 të KPPRK, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, kundërthënës me brendinë e tij dhe vetveten, pastaj gjykata ka bërë tejkalimin e akuzës, shkelje këto që aktgjykimin e bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm.

Sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë thuhet “ sepse me dt. 26.09.2016, rreth orës 20.00 i pandehuri pa **autorizim ka transportuar** substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë..., kështu që deri sa pjesëtarët e njësisë ROSU, në magjistralen Podujevë- Merdare kanë vendosur pikë kontrolli..... i pandehuri nuk është ndalur..., pastaj thuhet se me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Pra, mbrojtësi pretendon se gjykata të dënuarin nuk e shpall fajtor për transportimin e narkotikut ashtu siç e ka precizuar përfaqësuesi i akuzës në shqyrtimin e dytë gjyqësor, të cilin veprim i dënuari ka pranuar në të gjitha fazat e procedurës, por nuk e kishte ditur se çka kishte në çanta, ndërkaq shpallet fajtor për veprime tjera të cilat fare nuk i ka kryer. Pretendohet se kjo paraqet shkelje të ligjit në dëm të dënuarit ngase askush nuk mund të shpallet fajtor dhe të dënohet për veprime të cilat nuk i ka kryer.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par. 1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i ankimuar, rezulton se i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbajtësin e tij, e duke i ditur pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë me vullnet dhe vetëdije të plotë e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihej në barrë sipas aktakuzës. Mbrojtësi i të akuzuarit av. A.Gj. e ka mbështet pranimin e fajësisë së të akuzuarit, i cili pranim është bërë me vullnetin e tij të plotë.

Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësojë si të pabazuara pretendimet nga kërkesa e mbrojtësit të dënuarit K.S. , lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë në raport me të dënuarin është i qartë dhe konkret, nuk ka kundërthënie me vetveten dhe me arsyetimin. Në arsyetimet e aktgjykimeve të dy gjykatave në mënyrë të drejtë janë vlerësuar provat e administruara e duke dhënë arsyet për të gjitha pikat e aktakuzës. Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret dhe gjykata e shkallës së parë ka aprovuar pranimin e fajësisë konform dispozitave ligjore të KPP-së. Nga shkresat e lëndës dhe procesverbalet e shqyrtimit nuk shihet se Prokuroria e Shtetit të jetë

deklaruar rreth ndonjë ndryshimi të aktit akuzues., prandaj në këtë rast nuk kemi tejkalim të akuzës siç pretendohet në kërkesën e mbrojtësit, pasi që dispozita ligjore për veprën për të cilën është shpallur fajtor i dënuari përmban pikërisht atë çka pretendon mbrojtësi i të dënuarit – transportin, dhe se kjo vepër penale përfshin shpërndarjen, shitjen, transportimin, dorëzimin, ndërmjetësimin e preparateve të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substanca psikotrope ose analoge, prandaj e njëjta vetëm transportin nuk e specifikon por të njëjtën e ka bërë gjykata në dispozitiv të aktgjykimit ku fare qartë thekson nder të tjera..**se i pandehuri pa autorizim ka transportuar substanca narkotike.**

Pretendimet e mbrojtësit se bëhet fjale për shkeljen e ligjit penal në dëm të dënuarit sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara.

Në parag.2 të nenit 273, janë paraparë edhe katër forma tjera të veprimit me të cilat kryhet kjo vepër penale, këto janë shpërndarja, shitja **transportimi** apo dërgimi me qëllim shpërndarje, shitje, ose ofertë për shitje të narkotikëve, substancave psikotropike a substancave analoge të cilat janë shpallur të rrezikshme për shëndetin e njeriut.

**Me transport të pa autorizuar**, gjithashtu duhet nënkuptuar në përputhje me të drejtën e trafikut publik, që do të thotë bartjen e çdo sasive të drogës prej një vendi në një vend tjetër me mjete transportuese ose me forcën e vet fizike.

Po ashtu nuk qëndron pretendimi i mbrojtësit nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë sa i përket dënimit plotësues lidhur me konfiskimin e sendeve, konfiskimit të veturës GOLF 3, telefonit Iphone dhe kartelës së Z.mobil, As në këtë rast nuk kemi tejkalim të akuzës dhe nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit se nuk ka pasur propozim të prokurorisë, pasi që nga shkresat e lëndës , nga akti akuzues rezulton se prokuroria ka propozuar që konform nenit 69 të KPRK të akuzuarit ti konfiskohet vetura Golf 3 ngjyrë e kuqe me targa të regjistrimit 01-112-AB si mjet me të cilin i akuzuari ka transportuar substancat narkotike.

Për arsyet e paraqitura më lartë rezultojnë të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, andaj e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË  
Më 20.02.2018, Pml.nr.183/2017

Procesmbajtësja,  
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,  
Nesrin Lushta